

VENDIM
Nr. 66, datë 24.2.2000

PËR KËSHILLAT MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE ANONIME SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3, të ligjit nr. 8237, datë 1.9.1997, "Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore, që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore të jetë:

- për shoqëritë jostrategjike, të vogla e të mesme, tre anëtarë;
- për shoqëritë e sektorëve strategjikë, me rëndësi të veçantë, deri në gjashtë anëtarë.

2. Në përbërje të këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime duhet të jenë nëpunës të institucioneve shtetërore, qëndrore dhe vendore, kur legjislacioni nuk pengon pjesëmarrjen e tyre në funksione të tjera.

Në këshillat mbikëqyrës mund të emërohen edhe punonjës të bankave, të institucioneve kërkimore e shkencore, të universiteteve, si dhe personat që gëzojnë autoritet në fusha të caktuara.

Nuk mund të emërohen anëtar të këshillave mbikëqyrës, punonjës të organeve qëndrore a vendore, që kryejnë funksione kontroll-revizioni, punonjës që janë emëruar në drejtoritë e shoqërive tregtare ose janë drejtorë të ndërmarrjeve shtetërore të patransformuara në shoqëri tregtare, persona që nuk janë në marrëdhënie pune me shtetin, përveç rasteve të përcaktuara në paragrafin e dytë të kësaj pike.

Pjesëmarrja në këshillin mbikëqyrës do të bëhet sipas paragrafit të fundit të nenit 107, të ligjit "Për shoqëritë tregtare".

3. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës përfitojnë:

- Shpërblim për pjesëmarrje në këshillat mbikëqyrës, për kryetarin në masën 30 për qind e pagës mujore të drejtorit të shoqërisë, dhe në masën 20 për qind për anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës.

- Shpërblim për shpërblime a detyra që u besohen anëtarëve të këshillit mbikëqyrës nga këshilli, nga kryetari i këshillit apo nga ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Masa e shpërblimit miratohet nga ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, me propozimin e këshillit mbikëqyrës.

4. Shpërblim i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës është mujor. Ai fillon nga mbledhja e parë e tij dhe përballohet nga vetë shoqëria anonime.

Në mbledhjen e parë zgjidhet kryetari, nënkryetari, sekretari i këshillit mbikëqyrës dhe caktohet masa e shpërblimit për sekretarin.

Këshilli mbikëqyrës mblidhet jo më pak se katër herë në vit.

5. Këshilli mbikëqyrës i raporton ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në drejtorinë e administrimit të pronës publike, me cilësinë e përfaqësuesit të pronës shtetërore 4 herë në vit, për veprimtarinë financiare të shoqërisë.

6. Në pikën 1, rreshti i dytë i vendimit nr.720, datë 29.11.1995, të Këshillit të Ministrave, "Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore" hiqen fjalët "këshilla mbikëqyrës".

7. Vendimet nr.279, datë 9.5.1998 dhe nr.478, datë 20.10.1999, të Këshillit të Ministrave, si dhe akte të tjera nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

8. Ngarkohet ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta